

R E L A C I O N

I PROJEKTLIGJIT PËR SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN, GRUMBULLIMIN E TRAJTIMIN E UJRAVE TË NDOTURA URBANE

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka si qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor që siguron kushtet optimale për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në të gjithë vendin.

Objektivat kryesore të Projektligjit janë ndërtimi i kornizës institucionale, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në kuadrin e përmbushjes së funksioneve politikëbërëse, rregullatore, menaxheriale dhe operacionale, ngritjen e mekanizmave që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore në veçanti dhe krijimin e mekanizmave që promovojnë ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, si dhe promovimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektligji nuk është parashikuar në Programin analitik të akteve për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Hartimi i Projektligjit për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane, është iniciuar nga mungesa e legjislacionit parësor në fushën e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Ky projektligj, ndër të tjera ka si fushë veprimi

përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e secilit institucion që ushtron drejtpërdrejtë funksione politikbërëse, rregulluese, menaxhuese dhe operacionale me qëllimin sigurimin e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, krijimin e mekanizmave që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe të operatorëve që ofrojnë këto shërbime, si dhe krijimin e mekanizmave që promovojnë jo vetëm ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore, por edhe të kushteve optimale të ofrimit të shërbimit, si dhe promovimin e mbrojtjes së konsumatorit.

Ky projekt-ligj sjell një përjasje të re për rritjen e performancës së sektorit, si në drejtim të qëndrueshmerisë financiare ashtu edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatoreve nga shoqëritë UK.

Projekt-ligji siguron vijimin e ndërveprimit të autoriteve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore për përmirësimin e performancës së shoqërive të UK, si dhe mundëson vazhdimin e iniciativës së ndërmarrë me reformën në sektor me anë të nënshkrimit të Kontratave të Performancës ndërmjet MIE dhe Bashkive përkatëse.

Miratimi i këtij projektligji është një qasje e re për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve që vuan prej dekadash nga problemet financiare dhe cilësia jo e kënaqshme e shërbimeve të ofruara për konsumatorët.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji propozohet duke u mbështetur në nenet 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin e ndonjë direktive, por projekt-ligji ngarkon Këshillimin e Ministrave për trasnpozimin e Direktivës 91/271/EEC të 21 majit 1991 lidhur me trajtimin e ujrave të ndotura urbane.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Kreu I - Dispozita të Përgjithshme, ku përfshihen qëllimi dhe objekti i ligjit, parimet e zhvillimit të sektorit, përkufizimet dhe fusha e veprimit dhe përjashtimet.

Kreu II – Kuadri Institucional i Sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e trajtimit të ujrave të ndotura, ku përfshihen përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të Këshillit të Ministrave, ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, mjedisin, shëndetin publik dhe mbrojtjen sociale, agjencisë përgjegjëse për burimet ujore, agjencisë qendrore përgjegjëse për ujësjellës kanalizimet, entit rregullator të ujit, njësive të qeverisjes vendore dhe shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve.

Kreu III – Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe i Informacionit, ku përfshihen programi kombëtar i trajnimit dhe certifikimit, pronësia e asetëve dhe aksioneve, menaxhimi i asetëve, sistemi i integruar i informacionit.

Kreu IV – Rregullimi Ligor i Ofrimit dhe Operimit të Shërbimit të Furnizimit me Ujë, Grumbullimit e Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane, ku përfshihen rregullimi i përgjithshëm, bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetqeverisjes vendore, bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, format e subjektit të kompetencave të përbashkëta, kontratat e performancës, marrëveshjet koncesionare dhe partneriteti publik privat si dhe operatori të alternativës së fundit, i cili do të marrë përsipër ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujrave të ndotura për një ose më shumë zona shërbimi në rast të mosperformancës nga operatori i licencuar.

KREU V- Kushtet e Ofrimit të Shërbimit dhe Sistemi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, ku përfshihen kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë, kushtet e shërbimit për largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, përbërja e rrjetit publik të furnizimit me ujë, plani për zhvillimin e rrjetit publik të furnizimit me ujë, zonat e mbrojtura dhe të sigurisë, impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit te pijshëm, lidhja e dy rrjeteve të shpërndarjes së ujit,

lidhja e konsumatorëve me rrjetin e furnizimit me ujë, marrëveshja e furnizimit me ujë me konsumatorët, lidhjet e paligjshme me rrjetin e furnizimit me ujë, ndërprerja e një konsumatori dhe rilidhja e tij, marrëveshja me konsumatorët debitorë, ndërprerja e furnizimit me ujë në situata emergjence, matja e konsumit të ujit, verifikimi i matësve, faturimi, mbrojtja e konsumatorëve, cilësia dhe higjena e ujit të pijshëm, përbërja e sitemit të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, lidhja e përdoruesve me sistemin e kanalizimeve, shkarkimi në sistemin publik të ujrave të ndotura urbane, sistemet individuale të mbledhjes së ujrave të ndotura, ndarja e sistemeve të kanalizimeve të ujrave të ndotura nga sistemet e kanalizimit të ujrave të shiut, ndërtimi, instalimi dhe operimi i sistemeve grumbulluese dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura për qendrat urbane.

KREU VI - Organizimi dhe Funksionimi i Entit Rregullator (ERRU), ku përfshihen organizimi i ERRU-së, përbërja e komisionit dhe emërimi i anëtarëve të tij, shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të bordit, personeli teknik dhe këshilltarët, mbledhjet dhe vendimet e komisionit, struktura, pagat dhe marrëdhëniet e punës, buxheti dhe financimi i ERRU-së, pavarësia e erru-së dhe konflikti i interesit, objektivat rregullatorë, detyrat dhe kompetencat e erru-së, kompetencat e komisionit, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të komisionit, raportimi, aksesimi i publikut në informacion, bashkëpunimi me autoritetet e tjera, veprimtaritë e liçencuara dhe përjashtimet, kushtet e liçencimit, procedurat e liçencimit, njoftimi për aplikimet për liçencë, refuzimi i një liçence, heqja e një liçence, ndryshimi i liçencës, ndalimi i transferimit të një liçence ose asetëve, aksesimi në llogaritë e të liçencuarve, veprimtaritë me tarifa të rregulluara, parimet e vendosjes së tarifave, rregullat dhe procedurat e miratimit të tarifave, monitorimi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, hetimi administrativ.

KREUVII - Kundërvajtjet Administrative, ku përfshihen sanksionet administrative, ankimi dhe ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative.

KREU VIII - Dispozita të Tjera, ku përfshihen çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë lidhur me ndërtimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe oprimin e infrastrukturës së nevojshme për furnizimin me ujë dhe grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, miratimi i akteve nënligjore, shfuqizimi i akteve dhe dispozitave të tjera ligjore, dispozita tranzitore dhe hyrja në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Enti Rregullator i Ujit, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Njësitë e qeverisjes Vendore, Shoqëritë e Ujësjiellës Kanalizimeve, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për zbatimin e ligjit pas miratimit në Këshillin e Ministrave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Me Urdhërin nr. 581, datë 18.07.2018 është ngritur grupi i punës për hartimin e ligjit të funksionimit të sektorit të ujësjiellës kanalizimeve.

Ky grup kishte për qëllim hartimin e projekt ligjit për sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin e trajtimit e ujrave të ndotura urbane, pa u kufizuar në identifikimin e masave të nevojshme që duhen marrë në lidhje me sektorin e ujësjiellës kanalizimeve, verifikimin e kuadrit ligjor ekzistues me qëllim që të mos ketë përplasje dhe tejkalim të kompetencave si dhe në propozimin e hartimit të kuadrit nënligjor përkatës për zbatimin e ligjit.

Ky grup i kryesuar nga Zëvendësministri që mbulon fushën e ujësjiellës kanalizimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Enërgjisë, ka punuar me asistencën e konsulentit të përzgjedhur nga GIZ.

Për diskutimin e draftligjit janë zhvilluar takime me institucionet si Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Enti Rregullator i Ujit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Shoqata e Bashkive, Shoqata e Ujësjiellës-Kanalizimeve, Shoqëria e Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë.

Gjatë këtyre takimeve u diskutua dhe u morën mendime dhe opinione lidhur me çështjet dhe problematikat që duheshin trajtuar në projekt-ligj si dhe u ra dakord mbi shumicën e komenteve të bëra nga institucionet përkatëse, komente të cilat janë pasqyruar në draftin që po dërgohet për mëndim në këtë fazë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-ligji nuk parashikon krijimin e ndonjë institucioni të ri publik në nivel qendror apo vendor që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e furnizimit me ujë dhe grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Për këtë arsye ky projekt-ligji nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim në rritjen e shpenzimeve buxhetore për ta. Shpenzimet qe buxheti i shtetit ka bërë për financimin e projekteve të ndryshme në ndërtimin e ujësjellësave ose të infrastrukturës së trajtimit të ujrave të ndotura urbane do të vijojnë të bëhen në përputhje me planet dhe strategjinë e qeverisë për sektorin.

MINISTËR

BELINDA BALLUKU